

**MIRË SE VINI NË ALPEX
OPERATORI I SISTEMIT, TRANSMISIONIT DHE TREGUT - KOSTT SH.A**

Me kënaqësi njoftojmë se Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut - KOSTT sh.a. është anëtari i parë i regjistruar i Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike- ALPEX sh.a për zonën ofertuese të Kosovës.

KOSTT sh.a me selinë e tij të vendosur në Rr. Isa Boletini, nr. 39, 10000 Prishtinë, nënshkroi Marrëveshjen e Anëtarësimit në Bursë dhe u bë Anëtar i ALPEX në Tregun e Ditës në Avancë.

KOSTT sh.a është krijuar në vitin 2006 dhe operon rrjetin në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 05/L-085 Për Energjinë Elektrike, Kodit të Rrjetit të Transmetimit, Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike, Marrëveshjeve dy ose shumë- palëshe dhe akteve të tjera ligjore në fuqi.

Në rolin e Operatorit të Sistemit, KOSTT sh.a operon Sistemin Elektroenergjetik duke përdorur teknikat më të mira bashkëkohore mbi operimin e sistemit të transmetimit dhe komponentëve të tij, si dhe duke siguruar balancën ndërmjet gjenerimit, shkëmbimit dhe konsumit të energjisë elektrike.

Kontakt

Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike-ALPEX sh.a – Dega në Kosovë

Adresa: Rr. Ali Pashe Tepelena kati i II-te Nr.1 , VIP TOWER, Prishtinë, Kosovë.

Email: info@alpex.al